

## **Vendim**

**Nr.754, datë 8.7.2009**

Për miratimin e kontratës, me ndarje prodhimi, për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve, në shqipëri, në tokë, në blloqe “2-3”, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe energjetikës, përfaqësuar nga Agjencia kombëtare e burimeve natyrore (AKBN), dhe “DWN Petroleum AG”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 13 të ligjit nr.7746, datë 28.7.1993 “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

Vendosi:

Miratimin e kontratës, me ndarje prodhimi, për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve, në Shqipëri, në tokë, në blloqet “2-3”, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, përfaqësuar nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) dhe “DWM Petroleum AG”, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtre.

Kryeministri

Sali Berisha